



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr 61 date.11/05/2001

**PER
ORGANIZIMIN E KONCERTEVE NE QYTETIN E TIRANES NE DATAT 04
DHE 05 QERSHOR ME GRUPIN E SKORPIONSAVE**

Mbështetur ne ligjin nr.8652, dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, Lgjit “Për buxhetin lokal në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.22 dt.13.02.2001 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2001” me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I

1. Të miratojë në parim kontratën e lidhur midis Bashkis Tiranë dhe Shoqërisë “Open Hearts” për organizimin e 2 koncerteve të grupit “Scorpions” në shumën prej 45.500 mijë lek (650.000 DM të konvertuara me kursin ditor)
2. Shuma e mësipërme do të përballohet pa interes nga Shoqëria e Sigurimeve “Sigal” sipas kontratës bashkëngjitur
3. Shlyerja e detyrimeve ndaj kësaj shoqërie do të përballohet nga të ardhurat e planifikuara për vitin 2001 si më poshtë:

Projektet kulturore	10.000.000 Lekë
Projektet sportive	6.000.000 Lekë
Ndërmarrja e Tregjeve	17.000.000 Lekë
Aparati i Bashkisë	12.500.000 Lekë

4. Të ardhurat e krijuara nga shitja e biletave për këto koncerte do të derdhen në buxhetin e Bashkisë duke rimbursuar plotësisht brenda datës 20 qershor pakësimet e kryera në pikën 3 të këtij vendimi
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kulturës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Ekonomike
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

Leonidha TOSKA

